



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2017

Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK

Prishtinë, 2018

RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2017

Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK

Prishtinë, 2018

Botuesi:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Copyright:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Përdorimi i të dhënave lejohet vetëm kur citohet burimi i të dhënave.

Parathënie

Publikimi “Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2017” përfshin të dhënat në dispozicion të raportuara nga institucionet shëndetësore dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK).

Në këtë publikim përfshihen të dhënat mbi definicionet, lindjet dhe vdekshmërinë e foshnjeve të ndarë sipas periudhave të ndryshme të jetës së foshnjeve. Të dhënat kryesore perinatale dhe lindjet janë të prezantuara sipas viteve 2000-2017. Lindjet janë të raportuara sipas niveleve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore publike dhe private.

Të porsalindurit janë të prezantuar sipas grup-peshës dhe mënyrës së lindjes.

Foshnjët e vdekura janë të prezantuara sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës, rradhës së lindjes, statusit martesor dhe nivelit të edukimit të nënës.

Koeficientët e vdekshmërisë perinatale dhe infantile janë të prezantuara sipas komunave.

Falenderojmë të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës të cilat ofruan bashkëpunim në mbledhjen e të dhënave. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si informacion shumë i dobishëm për t’u njohur më mirë me gjendjen perinatale në Kosovë.

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij hulumtimi për bashkëpunim duke dhënë vërejtje, komente dhe propozime me qëllim të ngritjes së cilësisë në këtë lëmi tejet të domodoshme për zhvillimin, planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor në Kosovë në dobi të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Prof. Dr. Naser Ramadani, MD., PhD., C.M.I.S., C.I.E.H.

Drejtor i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	6
PËRMBLEDHJE.....	7
DEFINICIONET.....	8
METODOLOGJIA.....	10
TËDHËNAT KRYESORE.....	11
LINDJET.....	12
VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVER.....	17
VDEKSHMËRIA FETALE.....	19
VDEKSHMËRIA PERINATALE.....	20
PËRFUNDIMI.....	24
REKOMANDIMET.....	26
BIBLIOGRAFIA.....	26

PËRMBLEDHJE

Në vitin 2017, sipas të dhënave të Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 30,275 lindje prej të cilave 6,712 janë lindje jashtë Kosovës. Nga gjithsej 23,563 lindje në Kosovë, kemi 23,402 të lindur gjallë dhe 161 të lindur vdekur.

Nga institucionet shëndetësore janë kryer me prerje cezariene 18.6% të lindjeve.

Sipas të dhënave të ASK, shkalla e vdekshmërisë fetale është 6.8‰, vdekshmërisë neonatale të hershme 5.6‰, vdekshmërisë perinatale 12.4‰ dhe vdekshmërisë infantile është 9.7‰.

DEFINICIONET

Indikatori Perinatal është indikator kyç dhe senzitiv i gjendjes shëndetësore dhe reflekton kujdesin prenatal, gjatë lindjes dhe kujdesin për të porsalindurit.

Poashtu reflekton si indikator i tërthortë për gjendjen shëndetësore të nënës, organizimin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Definicionet e indikatorëve janë shfrytëzuar nga korniza e treguesve të shëndetit të fëmijës dhe nënës e cila është produkt i grupit punues në nivel nacional dhe i përkrahur nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Republikën e Kosovë, Ministria e Shëndetësisë, IKSHPK dhe UNICEF-i.

I lindur nënkupton shpëputjen e tërësishme e fetusit të vdekur që peshon më shumë se 500 g apo të fetusit të gjallë nga trupi nënës pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë.

I lindur gjallë nënkupton shpëputjen e tërësishme nga trupi i nënës të produktit të konceptimit, pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë, i cili produkt pas ndarjes, merr frymë apo tregon shenja të jetës si p.sh të rrahurat e zemrës, pulsimit të kordonit të kërthizës apo lëvizje vullnetare të muskujve, pavarësisht nëse kordoni i kërthizës është prerë apo placenta është ngjitur.

I lindur vdekur: Vdekja para daljes apo nxerrjes prej nënës së vet e produktit të konceptimit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatzënësisë; vdekja është përcaktuar sipas faktit se pas ndarjes së tillë fetusit nuk merr frymë apo nuk tregon ndonjë shenjë tjetër jete, siç janë rrahjet e zemrës, pulsimet e kordonit umbilikal apo lëvizjet e përcaktuara të muskujve të vullnetshëm (ASK)

Shkalla e të lindurve të vdekur (Vdekshmëria fetale)

Numri i të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur (të lindur gjallë dhe të lindur të vdekur). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes – gjatë shtatzënësisë dhe gjatë lindjes.

Për qëllime të krahasimeve kombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale (≥ 500 g ose ≥ 22 javë).

Për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ($\geq 1,000$ g ose ≥ 28 javë).

Shkalla e vdekshmërisë perinatale

Numri i vdekjeve perinatale (të lindur të vdekur dhe vdekje të hershme neonatale) e shprehur për 1,000 të lindur.

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (mortaliteti neonatal) definohet si numri i fëmijëve të lindur të gjallë që vdesin pa i mbushë 28 ditë të jetës (0-27 ditë) e shprehur për 1,000 të lindur gjallë brenda një viti kalendarik.

Vdekjet neonatale (vdekjet gjatë 28 ditëve të para të jetës së foshnjës) mund të ndahen në:

vdekjet e hershme neonatale, që ndodhin brenda 7 ditëve (0-6 ditë) të para të jetës dhe

vdekjet e vonshme neonatale që ndodhin pas ditës së 7, (7-27 ditë), por para se të përfundohet dita e 28-të.

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve paraqet numrin e foshnjeve të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-11 muaj) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore. Vdekshmëria e foshnjave paraqet probabilitetin që fëmija të vdesë para se t'i mbushë 1 vjet për 1,000 të lindur të gjallë.

Shkalla e vdekshmërisë maternale  aqet numrin e grave të vdekura nga ndonjë shkak që lidhet me (ose është shkaktuar nga) shtatzëninë (duke përfshirë shkaqe aksidentale apo të rastësishme) dhe vdekjet gjatë lindjes ose brenda 42 ditëve pas përfundimit të shtatzënisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe vendi i shtatzënisë, e shprehur në 100,000 të lindur gjallë, për një periudhë të caktuar kohore.

METODOLOGJIA

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave në nivel nacional. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) gjegjësisht Departamenti i Sistemit të Informimit e bënë raportimin e fenomeneve vitale në kuadër të institucioneve shëndetësore ndërsa Departamenti i Mjekësisë Sociale gjegjësisht njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe Rinisë bënë analizën e indikatorit të disagreguar.

- ASK është përgjegjës për grumbullimin e të dhënave nëpër hapat si më poshtë: çdo institucion shëndetësor dhe zyrë e gjendjes civile ka plotësuar Fletëzat statistikore për vdekje DEM-2
- Në baza mujore, institucionet shëndetësore dhe zyrat e gjendjes civile kanë raportuar në zyrat regjionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), duke dorëzuar kopjet fizike të të gjitha DEM-2 të plotësuar.
- Zyrat regjionale të ASK, me pasqyrën mujore të të dhënave për lindje dhe vdekje DEM-5, kanë raportuar në ASK.
- Departamenti i statistikave sociale – sektori i statistikave vitale në ASK, ka kontrolluar cilësinë dhe ka konfirmuar të gjitha të dhënat.
- Të gjitha të dhënat janë futur në programin Access në Departamentin e IT-së.
- Sektori i statistikave vitale ka kontrolluar të dhënat në databazën e vdekjeve dhe ka përpunuar të dhënat me SPSS.
- ASK ka publikuar në faqen e internetit raportin “Statistikat e vdekjeve”
- Kalkulimin e indikatorit të disagreguar sipas gjinisë, komunave, moshës dhe prezentimin e trendit e ka realizuar IKShPK, Departamenti i Mjekësisë Sociale, njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe Rinisë.

SFIDAT

- Për grumbullimin e të dhënave:
- Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sfida është mungesa e pyetësorit të standardizuar nga tri institucionet Agjencia së Statistikave të Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Ministria e Shëndetësisë, IKSHPK
- Përfshirja në raportim e të gjitha komunave të Kosovës.
- Shkaqet e vdekjeve mungojnë për vitin 2017 në nivel nacional gjë që reflekton në orientimin e masave intervenuese.

- Mortaliteti perinatal si indikator ndikohet prej faktorëve të jashtëm dhe jo vetëm prej kujdesit shëndetësor.

TË DHËNAT KRYESORE

Të dhënat perinatale kryesore për vitin 2017 të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private janë:

- 30,275 lindje, prej tyre 6,712 jashtë Kosove
- 23,563 lindje në Kosovë
- 23,402 të porsalindur gjallë
- 161 të lindur vdekur
- Raporti gjinor në lindje është 1,112 meshkuj në 1000 femra
- Shkalla e lindjeve me prerje Cezariane është 18.6 %
- Gjithsej 228 foshnje të vdekura
- 161 (6.8 ‰), vdekje fetale
- 132 (5.6 ‰) vdekje të hershme neonatale (0-6 ditë)
- 293 (12.4‰) vdekje perinatale (vdekje fetale + hershme neonatale)
- 47 (2.0‰) vdekje të vonshme neonatale (7-27 ditë)
- 179 (7.6‰) vdekje neonatale (0-28 ditë).

Shkalla e vdekshmërisë perinatale për të posalindurit me peshë $\geq 1,000$ gram që shfrytëzohet për krahasime ndërkombëtare është 12.4‰ (vdekshmëria fetale 6.8‰ dhe vdekshmëria e hershme neonatale 5.6 ‰).

Tabela 1. Të dhënat kryesore perinatale për vitin 2017

Modalitetet	2017
Numri i lindjeve	23,563
Numri i të porsalindurve të lindur të gjallë	23,402
Numri i vdekjeve fetale	161
Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	6.8
Numri i foshnjeve të vdekura në javën e parë	132.0
Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	5.6
Shkalla e vdekshmërisë perinatale (‰)	12.4
Shkalla e lindjeve me prerje cezariane (%)*	18.6

Burimi: ASK-Raportet: Lindjet, Vdekjet për 2017

*IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2017



LINDJET

Në vitin 2017, sipas të dhënave të ASK, janë raportuar gjithsej 30,275 lindje prej të cilave 6,712 janë lindje jashtë Kosovës. Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2017 kemi pasur gjithsej 23,563 lindje, prej tyre 23,402 (99.3%) të lindur të gjallë, 161 të lindur të vdekur në Kosovë. Sipas IKSHPK-së janë raportuar gjithsej 23,941 lindje (lehona), me 24,159 të lindur gjallë dhe 167 të lindur vdekur. Numri i të lindurve gjallë më i lartë se numri i lehonave (lindjeve) spjegohet me faktin se fëmijët e lindur kanë qenë bineq apo treneq (385 foshnje më shumë se lehona ose lindje) (Tab.2). Diferenca e numrit të lindjeve nga ASK dhe IKSHPK për vitin 2017 tregon përafrim të të dhënave krahasuar me vitet paraprake gjë që tregon përmirësim në raportimin e të dhënave.

Tab.2 Raportimi i të dhënave nga dy burimet e të dhënave

Institucioni	Lindje (lehona)	Të lindur gjallë	Të lindur vdekur
IKSHPK	23,941	24,159	167
ASK	23,563	23,402	161
Diferenca	378	757	6



Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2017
ASK-Statistikat e Lindjeve, 2017

Bazuar në raportin e IKSHPK-së: “Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2017”, sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në spitalet e përgjithshme me 12,884 apo 53.8%, pason klinika obsterike gjinekologjike e QKUK-së me 10,161 lindje apo 42.4%, në maternitete 533 lindje apo vetëm 2.2%, ndërsa në spitalet private, spitali Bahceci, spitalin Amerikan dhe International Hospital-Pejë 363 raste ose 1.5% (Tab.3).



Tab. 3 Lindjet sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, institucionit, Kosovë-2017


Institucioni	Gjithsej lindje (Lehona)		Gjithsej foshnje të lindura		Prej tyre të lindura gjallë		Prej tyre të lindura pa jetë	
	N	%	N	%	N	%	N	%
QKUK	10,161	42.4	10,438	42.9	10,326	42.7	112	67.1
Spitali	12,884	53.8	12,982	53.4	12,929	53.5	53	31.7
Materniteti jashtëspitalor	533	2.2	533	2.2	531	2.2	2	1.2
Gjithsej në Institucione Publike	23,578	98.5	23,953	98.5	23,786	98.5	167	100.0
Gjithsej në Institucione Private	363	1.5	373	1.5	373	1.5	0	0.0
Gjithsej	23,941	100.0	24,326	100.0	24,159	100.0	167	100.0

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2017

Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2017 kemi pasur gjithsej 23,563 lindje, prej tyre 23,402 (99.3%) të lindur të gjallë, 161 të lindur të vdekur (Tab.1). Lindje të gjalla sipas gjinisë ishin 11,081 meshkuj (47.4 %), kurse femra 12,321 (52.6%) dhe koeficient të maskulinitetit në lindje 1,112%.

Sipas raportit të IKSHPK-së, Analizës së Gjendjes Shëndetësore 2017, sipas rajonit më së shumti të lindur gjallë ka pasë në rajonin e Prishtinës me 6,933 (29.6%) pason rajoni i Prizrenit me 4,307 (18.4%) ndërsa më së paku ka në rajonin e Gjilanit 1995 (8.5%). Në nivel komunal, më së shumti të lindur gjallë kishte komuna e Prishtinës me 3,124 (13.3%) dhe Prizreni me 2,351 (10.0%) ndërsa më së paku në komunën e Ranillugës me vetëm 11(0.0%) (Graf.1).


Graf.1 Struktura e lindjeve sipas komunave, 2017



Burimi: ASK-Statistikat e Lindjeve, 2017

Trendi i lindjeve


Gjatë periudhës kohore 2000-2017 ka trend të rënies së numrit të lindjeve. Shihet se mesatarisht ka rënie mesatare prej 773 lindjeve në vit (Graf.2).



Graf.2 Trendi i lindjeve, Kosovë 2000-2017

Burimi: Statistikat e Lindjeve, 2017


Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në klinikën Gjinekologjike Obsterike të QKUK-së me 28 lindje, pason Prizreni me 9.6 lindje, Peja me 5.7 lindje dhe më së paku në Vushtrri me 1 lindje në ditë (Graf. 3).



Graf.3. Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2017

Gjatë vitit 2000, lindshmëria për 1000 banorë apo nataliteti ishte 19.3%, ndërsa në vitin 2017 ishte 13.0%. Lindshmëria për periudhën 2000-2017 ka trend të rënies me lëvizje variabile (Graf.4).



Graf.4 Trendi i natalitetit, Kosovë 2000-2017

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2017

Sipas peshës së lindjes, 1,113 (4.8%) janë me peshë të ulët në lindje, ndërsa 21,900 (93.6%) me peshë mbi 2,500 g, ndërsa mbi 4,000 g, 2,622 të lindur gjallë (11.2%). Pjesëmarrje më të madhe në lindje ka grup pesha 3000-3499g me 37.3% dhe 3500-3999g me 31.5%. (Tab.4)

Tab. 4 Të porsalindurit sipas peshës trupore

Gjithsej lindje të gjalla	Pesha në lindje										Xbar
	Më pak se 1000	1000-1499	1500-1999	2000-2499	2500-2999	3000-3499	3500-3999	4000-4499	4500 e më shumë	E panjohur	
23402	51	88	186	788	3181	8735	7362	2260	362	389	3,161
100	0.2	0.4	0.8	3.4	13.6	37.3	31.5	9.7	1.5	1.7	

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2017

Sipas grup-moshës të nënës, 8,443 (36.1%) të lindur gjallë janë nga nënat e grup-moshës 25-29 vjet, pasojnë nënat e grup-moshës 30-34 vjet me 5,993 (25.6%). Mosha mesatare e nënave ka qenë mosha 29 vjeçe.(Tab.5)

Tab. 5 Të lindurit gjallë sipas grup-moshave të nënës, 2017

Të lindur gjallë	Grupmosha e nënës									Mosha mesatare
	14 e më pak	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	E panjohur	
23,402	1	761	4,834	8,443	5,993	2,693	616	60	1	29
100	0.0	3.3	20.7	36.1	25.6	11.5	2.6	0.3	0.0	-

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2017

Sipas gjinisë së të porsalindurve dallimi është sinjifikant pasi që 12,321(52.4%) janë të gjinisë mashkullore dhe 11,081(47.4%) të gjinisë femërore.

Sipas vendit ku ka lindur fëmiju, 23,352 (99.8%) kanë lindur me ndihmë profesionale ndërsa sipas statutit martesor të prindërve 13,602(58.1%) janë të lindur në kurorë. (Tab. 6)



Tab. 6 Të lindur gjallë sipas gjinisë, statusit martesor të prindërve dhe vendit ku ka lindur fëmiju, 2017

Të lindur gjallë	Gjinia		Fëmija ka lindur:		Statusi martesor		
	Femra	Meshkuj	Në maternitet apo spital	Në vend tjetër	Në kurorë	Jashtë kurorës	E panjohur
23,402	11,081	12,321	23,352	50	13,602	9,475	325
100	47.4	52.6	99.8	0.2	58.1	40.5	1.4
χ^2	Sh1=1, p=0.00		Sh1=1, p=0.00		Sh1=2, p=0.00		

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2017


Nga institucionet shëndetësore raportohen 4,444(19.0%) lindje me prerje Cezariane, ndërsa në institucionet publike nga gjithsej 23,045 lindje, 2,325 (18.0%) në me prerje cezariane ndërsa në institucionet private nga gjithsej 363 lindje, 295 (81.3%) janë me prerje cezariane (Tab.7, Graf.5). Në klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së, 1,824 (18%) lindjeve janë me prerje Cezariane. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane është realizuar në spitalin e Gjakovës 749 (36.4%), pason spitali i Vushtrisë me 155 (33.3%)

dhe spitali i Pejës me 683(33.1%) (Tab. 5). Në spitale private kanë raportuar 295 (81.3%) lindje me prerje cezariane.

Tab.7 Lindjet me prerje Cezariane sipas institucioneve shëndetësore, Kosovë 2017

Institucioni		Komuna	Lindje me prerje cezariane		Gjithsej Lindje
			N	%	
Publike	QKUK	Prishtina	1,824	18.0	10,161
		Ferizaji	115	7.7	1,493
	Spitali	Gjilani	419	23.7	1,768
		Gjakova	749	36.4	2,059
		Peja	683	33.1	2,065
		Prizreni	31	0.9	3,521
		Mitrovica	173	11.4	1,512
		Vushtrria	155	33.3	466
		Gjithsej-institucione publike s		2,325	18.0
Gjithsej maternitete		-	-	-	
Gjithsej-institucione publike		4,149	18.0	23,045	
Private	Bahœci Health care		113	88.3	128
	Spitali Amerikan		178	77.7	229
	International Hospit		4	66.7	6
Gjithsej-institucionet private		295	81.3	363	
Gjithsej		4,444	19.0	23,408	

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2017



Graf. 5 Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2017

VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVE


Gjatë vitit 2017, institucionet shëndetësore publike dhe private kanë raportuar gjithsej 228 foshnje të vdekura. Prej gjithsej 228 foshnjeve të vdekura, 132 (57.9%) janë vdekje neonatale të hershme, (foshnje të vdekura 0-6 ditë), vdekjet neonatale (0 deri 28 ditë) përbëjnë 179 (78.1%), vdekje neonatale të vonshme janë 47 (20.2%) dhe 49 (21.9%) janë vdekje postneonatale (Tab.8, Graf 6).

Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2017 është 9.7‰. Sipas komunave, më i larti është në komunën e Shtërpces me 34.5‰ dhe Mamushës me 29.4‰. (Tab.13).

Tab. 8 Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës

Foshnje të vdekura	0- 24 orë	1-6 ditë	7-27 ditë	1-11 muaj	Gjithsej
N	31	101	47	49	228
%	13.6	44.3	20.6	21.5	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2017



Graf. 6 Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2017

Nga gjithsej 228 foshnje të vdekura, 139 (60.9%) janë meshkuj dhe 89 (39.03%) femra (Tab.9). Prej 228 foshnjeve të vdekura, sipas moshës dhe gjinisë nuk ka dallim sinjifikant (hi katror testi 3.98, Shl=2, p=0.13). Poashtu edhe sipas moshës së nënës dhe rradhës së lindjes së fëmijës statusit martesor nuk ka dallim sinjifikant (Tab. 9).

Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës dhe rradhës së lindjes së fëmijës nuk ka dallim sinjifikant. Sa i përket nivelit të edukimit 99 (43.4%) nga 228 foshnje të vdekura janë të nënave me shkollë të mesme dhe 67 (29.4 %) të nënave me shkollë fillore të kryer (Tab.10).

Tab. 9 Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës dhe rradhës së lindjes së fëmijut


Modalitete		Mosha e foshnjeve të vdekura			
		Gjithsej	Neon. e hershme	Neonatale	Post neonatale
		N			
		228	132	46	50
		%	57.9	20.2	21.9
Gjinia	Meshkuj	139	87	27	25
	Femra	89	45	19	25
	$\chi^2=0.398$, ShL=2, p=0.13				
Mosha e nënës	15-24	42	27	3	12
	25-34	122	71	24	27
	35+	64	34	19	11
	$\chi^2=8.47$, ShL=4, p=0.07				
Radha e lindjes së fëmijut	I pari	77	51	10	16
	I dyti	73	39	15	19
	I treti	46	25	12	9
	I katërti	26	14	8	4
	> I pesti	6	3	1	2
	$\chi^2=7.258$, ShL=8, p=0.509				

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2017

Tab. 10 Vdekshmëria e foshnjeve sipas statusit martesor të nënës, nivelit të edukimit të nënës

Statusi martesor dhe niveli i edukimit të nënës		Mosha e të foshnjeve të vdekura							
		Gjithsej		Neonatale e hershme		Neonatale		Postneonatale	
		N	%	N	%	N	%	N	%
Statusi martesor i nënës	Gjithsej	228	100.0	132	100.0	46	100.0	50	100.0
	E pamartuar	2	0.9	2	1.5	0	0.0	0	0.0
	E martuar	225	98.7	129	97.7	46	100.0	50	100.0
Niveli i edukimit të nënës	Pa shkollë	27	11.8	20	15.2	2	4.3	5	10.0
	Shkolla fillore e pa kryer	9	3.9	5	3.8	3	6.5	1	2.0
	Shkolla fillore e kryer	67	29.4	40	30.3	16	34.8	11	22.0
	Shkolla e mesme	99	43.4	53	40.2	17	37.0	29	58.0
	Shkolla e lartë	6	2.6	4	3.0	1	2.2	1	2.0
	Fakulteti	18	7.9	8	6.1	7	15.2	3	6.0
	E panjohur	2	0.9	2	1.5	0	0.0	0	0.0
	$\chi^2=13.453$, ShL=10, p=0.199								

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2017



Graf. 7 Vdekshmëria e foshnjeve sipas grup-moshës

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2017


VDEKSHMËRIA FETALE

Sipas IKSHPK, departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH), numri i foshnjeve të lindura vdekur për vitin 2017 ka qenë 167 ose vdekshmëri fetale 6.8%. Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 112 (67.1%) kanë ndodhë në QKUK. (Tab.11).

Tab.11 Foshnjat e lindura pa jetë sipas institucioneve shëndetësore, 2017

Institucioni	Foshnje të lindura pa jetë	
	N	%
QKUK	112	67.1
Spitali	53	31.7
Materniteti jashtëspitalo	2	1.2
Gjithsej	167	100.0


Sipas IKSHPK-së, në nivelin terciar në QKUK, në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, vdekshmëria fetale është më e larta 10.7%. Sa i përket spitaleve të përgjithshme, spitali i Pejës ka shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale (7.2%), pasuar nga spitali i Gjilanit me 6.8% dhe Gjakovës me 6.7%. Spitali i Ferizajit dhe Vushtrrisë nuk kanë raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale. Maternitetet e KPSH-së kanë raportuar 2 vdekje fetale. Këtë vit nuk janë regjistruar asnjë vdekje fetale në institucionet private. (Graf.8).



Graf. 8 Vdekshmëria fetale sipas institucioneve shëndetësore publike

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2017

Vdekshmëria fetale ka trend të rënies me lëvizje variabile. Në vitin 2000 shkalla e vdekshmërisë fetale ishte 14.5% ndërsa në vitin 2017 është 6.8% (Graf.9).



Graf. 9 Shkalla e vdekshmërisë fetale, 2000-2017

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2017

VDEKSHMËRIA PERINATALE

Vdekshmëria perinatale pasqyron vdekshmërinë fetale dhe vdekshmërinë e hershme neonatale së bashku për një periudhë të caktuar kohore në një territor të caktuar, për krahasim ndërkombëtar.

Në vitin 2017 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 12.4‰.

Sipas gjinisë mortaliteti perinatal tek meshkujt është 13.6‰ ndërsa tek femrat 11.4‰. (Tab.12)

Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2011-2017 tregon tendencë shumë të lehtë të rënies (0.08‰) me lëvizje variable (Graf.10).


Dallojnë vlerat e mortalitetit perinatal gjatë viteve 2011-2017 me raportet perinatale të mëhershme 2000-2015 të prezantuara në tabelën 1 varësisht prej burimit të të dhënave.

Bashkëpunimi i intensifikuar mes ASK, MSH dhe IKSHPK ka rezultuar me përafrim të të dhënave të raportuara krahasuar me vitet paraprake.

Sipas komunave shkalla më e lartë dhe shqetësuese është në komunën e Mamushë dhe 43.5‰ dhe Rahovecit me 22.6‰. (Tab.13).

Tab.12 Mortaliteti perinatal sipas gjinisë, 2017

Total	Mortaliteti perinatal ‰	
	M	F
12.4	13.6	11.4



Graf. 10 Trendi i mortalitetit perinatal, 2000-2017

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2017

Vdekshmëria e hershme neonatale (0 – 6 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale (0 – 6 ditë) për vitin 2017 është 5.6%. Sipas komunave gjegjësisht vendbanimit të foshnjeve, shkalla më e lartë e vdekshmërisë së hershme neonatale është në komunën Mamushë 29.4%, Shtërpçë 17.2%, Deçan 12.2% dhe Obiliq 9.2% (Tab.14).

Vdekshmëria neonatale e vonshme (7 – 27 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë së vonshme neonatale (7 – 27 ditë) për vitin 2016 është 2.0%. Sipas komunave, shkalla më e lartë e vdekshmërisë së vonshme neonatale është në komunën Shtërpçë 17.2%, Kamenicë 8.2%, Klinë 3.8%, dhe Gllgovc 3.7% (Tab.14).

Vdekshmëria neonatale (0-28 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (0-28 ditë) për vitin 2016 është 7.6%. Sipas komunave, shkalla më e lartë e vdekshmërisë neonatale është në komunën Shtërpçë 34.5%, Mamushë 29.4%, Kamenicë, Deçan dhe Prishtinë 12.2%. (Tab.14).

Vdekshmëria postneonatale (28-364 ditë)

Vdekshmëria postneonatale për vitin 2017 është 2.1%. Shkalla më e lartë e vdekshmërisë postneonatale ishte në komunën Skenderaj 5.9%, Istog 4.3%, Mitrovicë 3.4% (Tab.14).

Tab. 13 Shkalla e vdekshmërisë perinatale dhe infantile sipas komunave, 2017

Komuna	Perinatale	Infantile
Deçan	19.4	14.7
Gjakovë	11.0	5.1
Glogovc	9.7	11.0
Gjilan	15.2	9.0
Dragash	6.7	0.0
Istog	10.8	6.5
Kaçanik	6.6	4.4
Klina	13.1	13.2
Fushë Kosovë	10.9	8.2
Kamenicë	8.1	12.2
Mitrovicë	9.3	12.7
Leposaviq	0.0	0.0
Lipjan	16.2	11.3
Novobërdë	0.0	0.0
Obiliq	12.3	9.2
Rahovec	22.6	9.2
Pejë	17.2	10.0
Podujevë	14.9	11.2
Prishtinë	13.4	15.0
Prizren	8.5	6.0
Skenderaj	7.4	11.9
Shtime	15.7	10.6
Shtërpçë	17.2	34.5
Suharekë	16.6	9.0
Ferizaj	11.3	8.2
Viti	11.9	6.9
Vushtrri	12.4	11.5
Zubin Potok	0.0	0.0
Zveçan	0.0	0.0
Malishevë	7.3	6.1
Junik	0.0	0.0
Mamushë	43.5	29.4
Hani i Elezit	8.5	0.0
Graçanicë	0.0	0.0
Ranillug	0.0	0.0
Partesh	0.0	0.0
Kllokot	0.0	0.0
Mitrovicë e Veriut	0.0	0.0
Total	12.4	9.7

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2017

Tab. 14 Shkalla e vdekshmërisë infantile sipas komunave dhe moshës, 2017

Komuna	Mortaliteti			
	Neonatal i hershëm	Neonatal i vonshëm	Neonatal	Post- neonatal
Deçan	12.2	0.0	12.2	2.4
Gjakovë	1.7	1.7	3.4	1.7
Glllogovc	6.1	3.7	9.8	1.2
Gjilan	4.5	2.7	7.2	1.8
Dragash	0.0	0.0	0.0	0.0
Istog	2.2	0.0	2.2	4.3
Kaçanik	4.4	0.0	4.4	0.0
Klinë	7.5	3.8	11.3	1.9
Fushë Kosovë	4.1	1.4	5.5	2.7
Kamenicë	4.1	8.2	12.2	0.0
Mitrovicë	5.9	3.4	9.3	3.4
Leposaviq	0.0	0.0	0.0	0.0
Lipjan	7.6	2.5	10.1	1.3
Novobërdë	0.0	0.0	0.0	0.0
Obiliq	9.2	0.0	9.2	0.0
Rahovec	6.1	0.0	6.1	3.1
Pejë	7.5	1.7	9.1	0.8
Podujevë	7.5	2.8	10.3	0.9
Prishtinë	8.6	3.5	12.2	2.9
Prizren	3.0	0.4	3.4	2.6
Skenderaj	4.4	1.5	5.9	5.9
Shtime	5.3	2.7	8.0	2.7
Shtërpçë	17.2	17.2	34.5	0.0
Suharekë	7.7	0.0	7.7	1.3
Ferizaj	5.0	1.3	6.3	1.9
Viti	3.4	1.7	5.2	1.7
Vushtrri	5.7	2.9	8.6	2.9
Zubin Potok	0.0	0.0	0.0	0.0
Zveçan	0.0	0.0	0.0	0.0
Malishevë	2.5	2.5	4.9	1.2
Junik	0.0	0.0	0.0	0.0
Mamushë	29.4	0.0	29.4	0.0
Hani i Elezit	0.0	0.0	0.0	0.0
Graçanicë	0.0	0.0	0.0	0.0
Ranillug	0.0	0.0	0.0	0.0
Partesh	0.0	0.0	0.0	0.0
Klllokot	0.0	0.0	0.0	0.0
Mitrovicë e Veriut	0.0	0.0	0.0	0.0
Gjithsej	5.6	2.0	7.6	2.1

PËRFUNDIMI

- Në vitin 2017, sipas të dhënave të Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 30,275 lindje prej të cilave 6,712 janë lindje jashtë Kosovës.
- Prej gjithsej 23,563 lindje në Kosovë, 23,402 janë të lindur gjallë dhe 161 të lindur vdekur.
- Raporti gjinor në lindje është 1,112 meshkuj në çdo 1000 femra.
- Shkalla e lindjeve me prerje Cezariane është 18.6%.
- Sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në spitale rajonale me 12,884 apo 53.8%, pason QKUK me 10,161 apo 42.4%, në maternitete 533 lindje apo 2.2%, ndërsa në spitalet private të raportuara, spitali Bahceci, spitalin Amerikan dhe spitalin International Hospital-Pejë 363 raste ose 1.5%.
- Numri mesatar i lindjeve në ditë më i larti është në QKUK me 27.8 lindje, pason spitali i Prizrenit me 9.6 lindje.
- Lindshmëria për periudhën 2000-2017 ka trend të rënies me lëvizje variabile.
- Me grup-peshë < 2500g janë 5% të foshnjeve të porsalindura.
- Mosha mesatare e nënave ka qenë mosha 29 vjeçe.
- Sipas gjinisë së të porsalindurve, 12,321 (52.4%) janë të gjinisë mashkullore, me dallim sinjifikant.
- Me ndihmë profesionale kanë lindur 23,352 (99.8%).
- Sipas statutit martesor të prindërve 13,602 (58.1%) janë të lindur në kurorë.
- Në institucionet publike spitalore 24.3% janë lindje me prerje cezariane kurse në institucionet private spitali Bahceci, spitalin Amerikan dhe spitalin International Hospital-Pejë 58.1%.
- Në QKUK, 1,824 (18.0%) e lindjeve janë me prerje Cezariane. Prej spitaleve rajonale përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane është realizuar në spitalin e Gjakovës 749 (36.4%) dhe spitalin e Pejës me 683 (33.1%).
- Në spitale private kanë raportuar 295 (81.3%) lindje me prerje cezariane.
- Prej gjithsej 228 foshnjeve të vdekura prej tyre 161 (6.8‰) janë vdekje fetale, 132 (5.6‰) vdekje të hershme neonatale (0-6 ditë), 47 (2.0 ‰) vdekje të vonshme neonatale (7-27ditë), 179 (7.6‰) vdekje neonatale (0-28 ditë), 49 (2.1‰) vdekje postneonatale ndërsa vdekje perinatale (vdekje fetale + hershme neonatale) janë 293(12.4‰).

- Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës dhe gjinisë, moshës dhe moshës së nënës, moshës dhe statusit martesor nuk ka dallim sinjifikant ndërsa sipas rradhës së lindjes së fëmijës në mënyrë sinjifikante ka ndodhë te fëmija i parë në familje.
- Prej 228 foshnjeve të vdekura, sipas moshës dhe gjinisë, moshës së nënës dhe rradhës së lindjes, nivelit të edukimit të nënës nuk ka dallim sinjifikant.
- Pjesa më e madhe e foshnjeve të vdekura 99 (43.4%) janë të nënave me shkollë të mesme.
- Vdekshmëria fetale për vitin 2017 është 6.8‰, sipas institucioneve në QKUK është më e larta 10.7‰, pason spitali i Pejës me 7.2‰. Spitalet private Bahceci, spitali Amerikan dhe spitali International Hospital-Pejë nuk janë raportuar asnjë rast.
- Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2017 është 9.7‰. Sipas komunave, më i larti është në komunën e Shtërpçës me 34.5‰ dhe Mamushës me 29.4‰.
- Në vitin 2017 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 12.4‰. Sipas komunave shkalla më e lartë është në komunën e Mamushës 43.5‰ dhe Rahovecit me 22.6‰.

REKOMANDIMET

- Në raportim të të dhënave perinatale të përfshihen të gjitha institucionet, publike dhe private si dhe të gjitha komunat.
- Të harmonizohet pyetësi për mbledhjen e të dhënave mes institucioneve relevante.
- Të organizohen trajnime të punëtorëve shëndetësorë për kodifikimin e shkaqeve të vdekjeve.
- Të përmirësohet niveli i raportimit të të dhënave për vdekjet maternale dhe shkaqet e vdekjeve të foshnjave.
- Të fuqizohet qasja multidisiplinare në përmirësimin e kujdesit prenatal, kujdesit natal përmes organizimit të aktiviteteve sipas pakos së OBSH-së “Every Newborn action plan to end preventable deaths” (MSH, IKSHPK, KPSH, KDSH, KTSH) pasi që komponenta e hershme neonatale e mortalitetit perinatal mund të reagojë relativisht shpejt në ndërhyrjet programatike si Pakoja e OBSH-së për Kujdesin esencial për të porsalindurit.
- Të hulumtohet mortaliteti perinatal prej 43.5% në komunën e Mamushës dhe Rahovecit 22.6% me inicimin e një komisioni punues për vlerësimin e shkaqeve të vdekjes, cilësisë së kujdesit prenatal, natal dhe postnatal dhe hulumtim për njohuri, qëndrimeve dhe praktikave të grave rreth shëndetit riprodhues dhe kujdesit për foshnjen.
- Të hartohen udhërrëfyesit dhe protokolet klinike dhe të monitorohet zbatimi i tyre në praktikë.
- Të planifikohet konform të gjeturave nga vlerësimi i performancës së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të fuqizohet më tutje edukimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve shëndetësor.
- Të përmirësohet infrastruktura, pajisjet dhe furnizimi me barna në institucione që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe foshnje.

BIBLIOGRAFIA

1. IKSHPK, Lindjet 2017
2. ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2017
3. ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2017